



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29803, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve privat Mehribane Shala, Fatmir (Vehbi) Muhagjeri dhe Mazllom (Vehbi) Muhaxheri, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, merr këtë:

VENDIM

Nr. 28/2025

**Mbi këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve privat me qëllim:
“Të formimit të rrugës” si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal**

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të formimit të rrugës si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr: 5509-3 në sipërfaqe prej 581m² ZK Pejë, pronë e bashkëpronarëve Mehribane Shala me 1/3, Fatmir (Vehbi) Muhagjeri me 1/3 dhe Mazllom (Vehbi) Muhaxheri me 1/3, do të merret me qëllim të formimit të rrugës si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr. 5755-115 me sipërfaqe prej 581m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, të aprovuara me datën 21.05.2025.
 - Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr.5755-115 në sipërfaqe prej 581m² ZK Pejë është vlerësuar me 80 €/m² që në total i bie 46,480.00 €
 - Prona private e bashkëpronarëve Mehribane Shala me 1/3, Fatmir (Vehbi) Muhaxheri me 1/3 dhe Mazllom (Vehbi) Muhaxheri me 1/3, me numër të ngastrës 5509-3 në sipërfaqe prej 581m² ZK Pejë është vlerësuar me 80 €/m² që në total i bie 46,480.00 €.
 - Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj